



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 296 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01

Data/Datum/Date 30/03/2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.03.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe më gjerë.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510046-00813-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 35595m² (tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë metra katror), zona kadastrale Hoçë e Vogël, e evidentuar në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen 500m² (pesëqind metra katror) për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe më gjerë.
4. Ky objekti do të financohet nga donatorët.
5. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në terren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.296/22
Me datë:30.03.2022

